



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Buletini Nr. 2



Mbështetje për
Organizatat e Shoqërisë
Civile
për të zhvilluar
Ndërmarrje
Sociale

PERMBLEDHJE E REZULTATEVE TE PROJEKTIT

Projekti **“Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile për të zhvilluar Ndërmarrje Sociale”**, financohet nga fonde të Bashkimit Evropian.

Qendra për Promovimin e Konkurrueshmërisë, në bashkëpunim me organizatën partnere, Agjencinë Rajonale të Zhvillimit Tiranë janë angazhuar plotësisht në zbatimin e veprimtarive të parashikuara në projekt sipas afateve të përcaktuara.

Në vitin e parë, projekti u fokusua në drejtim të analizës për përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor për ndërmarrjet Sociale. Dy tryeza konsultimesh me organizatat e shoqërisë civile mbi Ligjin dhe aktet e tjera nënligjore të aprovuara së fundmi nga Qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u zhvilluan në muajt e fundit të Vitit 2018, në 25 tetor dhe 13 Dhjetor 2018, respektivisht në qytetet e Vlorës dhe Tiranës. Pas përfundimit të konsultimeve një dokument politikash mbi kuadrin ligjor për Ndërmarrjet Sociale u përgatit në gjuhën angleze dhe atë shqipe. Materiali iu dërgua Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për ta konsideruar për përmirësimin e problematikave të nxjerra nga analiza e kërkesave të Ligjit apo edhe

problematikat e hasura nga zbatimi i drejtpërdrejtë i ligjit nga disa organizatave, si dhe u shpërnda tek një numër organizatash të interesuara për këtë sektor.

Një studim në terren për mundësitë që ofrohen për Organizatat e Shoqërisë Civile për të ngritur Ndërmarrje Sociale, u realizua në periudhën Tetor 2018-Shkurt 2019. Bazuar në pyetësorin e përgatitur për këtë qëllim, rreth 80 organizata dhanë opinionet e tyre për mundësitë dhe potencialet e Shqipërisë për të zhvilluar Ndërmarrje Sociale, cilat ishin fushat më potenciale në këtë sektor, zonat ku Ndërmarrjet Sociale ishin më të zhvilluara dhe se cilat ishin kapacitetet njerëzore dhe mundësitë financiare të organizatave për të krijuar këto struktura.

Rezultatet e studimit i paraprinë përgatitjes së një moduli trajnimi se si të planifikohet biznesi dhe si të strukturohet dhe shkruhet Plani i Biznesit.

6 (gjashtë) seanca trajnimesh 3-ditore u mbajtën në disa rrethe të vendit, në Tiranë u mbajtën dy seanca, Durrës, Shkodër, Korçë dhe Vlorë.

Rreth 120 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, nga rreth 10 zona të ndryshme, morën pjesë në këto trajnime.

PERMBAJTJA

Rezultatet e projektit	1
Trajnime në kuadër të projektit	2
Foto nga seancat e trajnimeve	2
Konsultime për kuadrin ligjor-NS	3
Dokumenta për NS	3
Thirrja për Aplikime Nr.1	4
Partnët në Projekt	4

Informacion më të detajuar mbi Projektin do të gjeni në:

Website dhe Mediat Sociale

<http://www.ccp.al>
<http://www.rdatirana.al>

www.facebook.com/SocialEnterprises-CSOs

www.facebook.com/ccpalbania

"Ky material komunikimi reflekton vetëm pikëpamjet e autorëve dhe Bashkimi Evropian nuk është përgjegjës për përdorimin e përmbajtjes së këtij informacioni"

TRAJNIME NË KUADËR TË PROJEKTIT

Për ngritjen e kapaciteteve të organizatave jo-fitimprurëse me njohuri dhe aftësi të planifikimit të një biznesi dhe realizimit konkret të planit të biznesit, me ndihmën e dy ekspertëve u përgatit moduli me temë **“Si të shkruajmë një Plan Biznesi për Ndërmarrjet Sociale”**.

Moduli ishte i përgatitur posaçërisht për këtë kategori, ku fokusi kryesor ishte në dhënien e njohurive mbi konceptet kryesore të analizës së tregut, konkurrentëve, mënyrën e realizimit të marketingut, parashikimit të shitjeve, blerjeve të lëndëve të para, personelit, si dhe parashikimet financiare, etj. Pjesëmarrësit u ushtruan praktikisht në plotësimin e një skelet plani biznesi brenda kohës së trajnimit.

Në ditën e parë të trajnimit Znj. Alida Kondi, drejtuese e Organizatës Qendra për Promovimin e Konkurrushmerisë,

paraqiti një përmbledhje të Ligjit të Ndërmarrjeve sociale dhe kuadrit tjetër ligjor plotësues, për ta bërë sa më të qartë kontekstin në të cilin po organizohej trajnimi, si dhe për të promovuar dhe informuar organizatat në lidhje me këtë mundësi të krijuar, që ta shfrytëzojnë për të rritur të ardhurat të tyre duke u fokusuar në një veprimtari ekonomike, por duke ruajtur qartësisht misionin e tyre social.

Gjithashtu u diskutuan disa nga problematikat e ngritura nga organizatat në lidhje me kuadrin ligjor dhe zbatueshmërinë e tij. Në ditët e fundit të trajnimit u shpjegua në lidhje me fondin e venë në dispozicion nga projekti për të mbështetur krijimin dhe zhvillimin e NS, si dhe pyetje të tjera që u adresuan nga pjesëmarrësit në fund të trajnimit.

Sesioni i parë i trajnimit u mbajt në Tiranë në datat 19-21 Shkurt 2019 dhe i dyti në datat 27-28 Shkurt dhe 1 Mars.

Interesi nga organizatat ishte i lartë. Ishte e rëndësishme që pjesëmarrësit të kuptonin dallimin midis një projekti me afate të kufizuara dhe një veprimtari e cila duhet të siguronte një veprimtari ekonomike të qëndrueshme.

Dy seanca të tjera të trajnimit u mbajtën në qytetin e Shkodrës me datat 6-8 Mars 2019 dhe Vlorë 26-28 Mars. Në muajin Prill sesionet e trajnimit u organizuan në Korçë, ndërsa për të gjithë pjesëmarrësit nga disa zona që nuk kishin pasur mundësi më parë të ndiqni trajnimin u ftuan në qytetin e Durrësit, në sesioni i gjashtë i trajnimit me të njëjtën temë.

Nga pjesëmarrësit u dha vlerësim shumë i mirë për ekspertizën e trajnerëve si dhe për organizimin, në përgjithësi.

Numri i pjesëmarrësve në këtë trajnimi arriti në 120 persona përfaqësues të mbi 100 organizatave të ndryshme nga të gjithë Shqipëria.


FOTO NGA SEANCAT E TRAJNIMEVE



*Trajnimi i zhvilluar në Tiranë
19-21 Shkurt 2019, Hotel "TAFAJ"*



*Trajnimi i zhvilluar në Tiranë
28-29 Shkurt dhe 1 Mars 2019, Hotel "TAFAJ"*



*Trajnimi i zhvilluar në Shkodër
6-8 Mars Shkurt 2019, Qendra "ARKA"*



*Trajnimi i zhvilluar në Vlorë
26-28 Mars 2019, Hotel "New York"*



*Trajnimi i zhvilluar në Korçë
3-5 Prill 2019, Hotel "GRAND"*



*Trajnimi i zhvilluar në Durrës
24-26 Prill 2019, Hotel "ARBI"*

KONSULTIME PËR KUADRIN LIGJOR TË NDËRMARRJEVE SOCIALE

Një takim i dytë konsultativ me organizatat e shoqërisë civile për kuadrin ligjor të ndërmarrjeve Sociale u organizua me datë 13 Dhjetor 2018 në qytetin e Tiranës, i mbajtur në mjediset e “Oficina”. Në këtë veprimtari morën pjesë rreth 42 pjesëmarrës nga organizatat e qytetit të Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Fierit, etj. Pas përshëndetjes së Z. Ilir Rëmbeci, u mbajt një prezantim i shkurtër nga Znj. Alida Kondi, drejtore e projektit, për përfitimet e pritshme nga ky projekt, veçanërisht për mundësinë e përfitimit të granteve për organizatat që duan të krijojnë Ndërmarrje Sociale.

Eksperti i projektit, Z. Bashkim Sykja, shpjegoi konceptin e Ndërmarrjes Sociale, që nga kriteret e qeverisjes; shkalla e autonomisë; fuqia vendim-marrëse; pronësia; kriteri ekonomik; kriteri social; kufizim në shpërndarjen e fitimit; burimet e financimit; pjesëmarrja në prokurime publike; statusi i ndërmarrjes sociale, etj. Një shpjegim i detajuar u dha mbi aktet e tjera nën-ligjore, të cilat janë aprovur kohën e fundit nga Qeveria Shqiptare.

Takimi u ndoq me shumë interes dhe diskutime të zgjatura pati në pjesën e dytë të veprimtarisë. Shumë prej pjesëmarrësve ngritën pyetjet e tyre për paqartësitë që kishin në lidhje me detaje të veçanta të ligjit dhe akteve nënligjore, ku një sërë pyetjesh që u ngritën nga pjesëmarrësit nuk gjenin dot përgjigje në kuadrin aktual që është në fuqi.



DOKUMENTA PËR NDËRMARRJET SOCIALE

Dy dokumenta të rëndësishëm janë prodhuar nga Projekti:

I pari është “**Dokument Politikash mbi Mjedisin Ligjor të sektorit të NS, gjetjet dhe sfidat**”, një dokument që analizon kuadrin ligjor të Ndërmarrjeve Sociale (NS) në Shqipëri, mënyrën si i mbështetet kuadri ligjor aktual OShC-të, për të krijuar ndërmarrje sociale, cilat janë boshllëqet dhe vështirësitë e identifikuara në procesin e zbatimit të Ligjit, për të ofruar disa rekomandime politikash në lidhje me zhvillimin e sipërmarrjes sociale në Shqipëri.

Përgatitja e këtij dokumenti ka kaluar përmes procese konsultimesh. Ligji Nr.65 / 2016 "Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë" është në fuqi, por ende nuk po zbatohet plotësisht. Aktet nënligjore / aktet plotësuese që lehtësojnë zbatimin e Ligjit, janë përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por ka mungesë informacioni mbi zbatimin real të Ligjit dhe është vërtet e vështirë të matet ndikimi real i kuadrit ligjor të NS, në vend.

I dyti, është një “**Raport mbi Vlerësimin e potencialeve në vend për zhvillimin e Ndërmarrjeve Sociale në Shqipëri**”.

Raporti është përgatitur pas një studimi në terren mbi situatën e ndërmarrjeve sociale në sektorin e OShC-ve, duke synuar identifikimin e fushave të mundshme për të zhvilluar ndërmarrjet sociale, si dhe nevojat dhe kapacitetet e OShC-ve për të menaxhuar ndërmarrjet sociale, identifikimin e praktikave të mira, të cilat mund të ndihmojnë në hartimin e veprimeve të duhura për të ndihmuar zhvillimin e sektorit.

Metodologjia e anketës u bazua në një analizë cilësore dhe sasiore, duke mbledhur të dhëna parësore nga të paktën 16 qytete të ndryshme të Shqipërisë. U realizuan tetëdhjetë (80) intervista, si dhe diskutime në fokus grupe me organizata nga qarqet e Shkodrës, Fierit, Vlorës dhe Tiranës.

Raporti hedh dritë mbi situatën e sektorit të OShC-ve në Shqipëri në lidhje me madhësinë, format e organizatave dhe të ardhurat e fituara çdo vit. Rezultatet tregojnë se sektori është relativisht i vogël në numër, me një mesatare prej 2-4 punonjës, me kohë të plotë dhe të ardhurat që shkojnë nga 20-50 mijë Euro. Gjithsesi ka një optimizëm të lartë për perspektivën e zhvillimit të sektorit, për rritjen e numrit të të punësuarve dhe diversifikimin e shërbimeve.

Një informacion më i zgjeruar do të jepet në buletinet e ardhshme.

THIRRJE PËR APLIKIME Nr. 1

PER ORGANIZATAT E SHOQERISE CIVILE QE KRIJOJNE NDERMARRJE SOCIALE

Fondi në dispozicion 77,600 Euro. Madhësia e Grantit nga 2,000 – 4,000 Euro
30 organizata jo-fitimprurëse do të jenë përfituese

Kriteret e ligjshme për aplikantët:

- * Çdo organizatë shqiptare jo-fitimprurëse e rregjistruar në gjykatë së paku 3 muaj përpara hapjes së kësaj thirrjeje DHE
- * Vepron në territorin e Shqipërisë DHE
- * Është përgjegjëse e drejtpërdrejtë për zbatimin e planit të biznesit dhe jo ndërmjetëse.

Kritere specifike për të përfituar:

- * Nje ide biznesi e qendrueshme
- * OJF që veprojnë në zona rurale
- * Veprimtari me ndikim të fortë social
- * Veprimtari ku përfitojnë persona nga shtresat e pafavorizuara të shoqërisë

Kostot e lejueshme për t'u mbështetur nga skema e granteve:

- * Pagat për stafin për një periudhë 3 mujore me një pagë bruto mujore prej 36,000 lekësh për një maksimum prej 2 personash;
- * Sigurimi social dhe shëndetësor i punonjësit dhe punëdhënësit për një periudhë gjashtëmujore për një nivel të pagës bruto prej 24000-60000;
- * Blerja e makinerive, mjeteve dhe pajisjeve, ose mjeteve të transportit, si dhe softuerit të lidhur direkt me prodhimin dhe / ose shërbimin;
- * Blerje para fillimit të lëndëve të para në rast se ato janë shumë të domosdoshme (vetëm një herë);
- * Blerja e materialeve për mobilimin ose rregullimin e objekteve për biznes (vetëm 30%, përveç aktiviteteve të mikpritjes që janë 50% të lejuara);
- * Hapësira me qira për një periudhë maksimale prej 6 muajsh

Kërkesa për Paketën e Aplikimit në adresën alida.kondi@gmail.com/faola.hodaj@yahoo.com, ose në rrjetet sociale të projektit www.facebook.com/SocialEnterprisesforCSOs ose www.facebook.com/ccpalbania

Të gjitha pyetjet lidhur me aplikimin mund të dërgohen në kontaktet e mësipërme brenda datës **9 Gusht 2019**.

ORGANIZATAT ZBATUESE TË PROJEKTIT



Adresa: Rr."Durrësit" P.7/1/1,
Tiranë -ALBANIA
E-mail: info@ccp.al;
Tel +355 692141920;
Web: www.ccp.al,
www.facebook.com/ccpalbania
Person Kontakti: Alida Kondi



Adresa: Rruga "Ismail Qemali" P 34/1,
Ap3, Tirane
Tel & Fax: [04 254603](tel:+3554254603)/ [04 235704](tel:+3554235704),
e-mail: ilirda@albmail.com
Person Kontakti: Ilir Rembeci

Qendra për Promovimin e Konkurrueshmërisë (CCP) është një organizatë jo-fitimprurëse, që ushtron veprimtarinë e saj që prej vitit 2011. Ajo ka fokusin kryesor në drejtim të ofrimit të mbështetjes për biznesin dhe zhvillimin e sipërmarrjes, nxitjen e start-up dhe zhvillimin e ekonomisë sociale. Organizata ka eksperiencë në menaxhimin e projekteve. Ajo ka eksperiencë të gjërë duke punuar me aktorët e biznesit, institucionet publike dhe donatorët në ofrimin e shërbimeve mbështetëse për biznesin, trajnime për kompanitë dhe të rinjtë sipërmarrës, kërkime tregu, studime dhe raporte dhe veprimtari promovuese.

Agjencia Rajonale e Zhvillimit (ARZH) u themelua në vitin 1998. Misioni i saj kryesor është mbështetja e zhvillimit të sektorit të Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Shqipëri. Me mbi 20 vite përvojë, ARZH ka përmbushur detyra të rëndësishme duke kontribuar me punë pranë komunitetit lokal të biznesit, kontribuesve ndërkombëtare, autoriteteve qendrore e lokale si dhe OJQ-ve për të përmirësuar klimën e biznesit dhe inkurajuar zhvillim ekonomik në rajon nëpërmjet implementimit të programeve të përbashkëta koordinuese, si dhe ka shërbyer si një qendër resursesh kros-sektoriale. Organizata ofron trajnime, studime tregu, planifikime biznesi, nxitje të sipërmarrjes dhe menaxhime projektesh.